



Datë: 26.12.2025

Numër Protokolli: 8144/2025

A.nr.1442/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1442/2025, të datës 22.07.2025, të parashtruar nga ankuesi A.S, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*pezullim nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1442/2025, e datës 22.07.2025, e parashtruar nga ankuesi A.S.

A r s y e t i m

Ankuesi A.S (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 22.07.2025, fizikisht ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos shqyrtimit të kërkesës për kthim në vendin e punës, anulimit të vendimit të kundërligjshëm për pezullim nga puna dhe kthimi në vendin e punës dhe kompensimin e diferencës së pagës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit, më datë 22.08.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4891/2025 të datës 22.07.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Emaili i datës 18.06.2025 nga ankuesi për A.G; Kërkesën për kthim në vendin e punës dhe pagesën e plotë të pagave nga ankuesi për Ministrinë e Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr. 1132/2023 i datës 12.07.2023 i Komisionit Disiplinor;

Vendimin me Nr. 2109/2023 i datës 20.12.2023 për pezullimin e marrëdhënies së punës së ankuesit; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.07.2025; Provë shtesë nga ankuesi; Emailin e datës 09.07.2025 nga A.G për F.I; Përgjigje në ankesë e datës 22.08.2025; Akt Emërimit me Nr. 58 të datës 23.04.2019; Emailin i datës 01.09.2025 nga Prokurori i Shtetit, Prokuroria Themelore ne Prishtinës për MPB; Emaili i datës 01.09.2025 nga MPB për Prokurorinë e Shtetit dhe emaili i datës 01.09.2025 nga MPB për KPMSHCK-në.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankueses nuk është e bazuar, sepse:

Vlerësimi i gjendjes së fakteve

Nga provat e administruara rrjedhë se:

- ankuesi sipas Akt Emërimit me Nr. 58 të datës 23.04.2019, mbanë pozitën e punës Zyrtar i Prokurimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
- Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke u bazuar në nenin 48, paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më Vendimin Nr. 1132/2023, të datës 12.07.2023 ka bërë pezullimin e marrëdhënies së punës së ankuesit me 50% të pagës deri në gjashtë (6) muaj.
- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 20.12.2023, në mbështetje të nenit 69, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më Vendim Nr. 2109/2023, të datës 20.12.2023, ankuesin e ka pezulluar nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.

Ankuesi më datë 18.06.2025, i është drejtuar më kërkesë Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për kthim në vendin e punës dhe pagesën e plotë të pagave me arsyetimin se me Ligjin Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L197 për Zyrtarët Publikë, është ndryshuar neni 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, ku thuhet: Ndaj nëpunësit civil është ngritur aktakuza për procedurë penale për kryerjen të veprës penale gjatë ushtrimit funksioneve të tij, e duke qenë se nuk është ngritur aktakuza kërkon kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e pagave prej 50% nga dita e pezullimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se pas ndryshimit të rrethanave juridike sipas Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me të cilën përcaktohet se nëpunësi civil pezullohet vetëm kur ka të ngritur një aktakuzë, atëherë, meqenëse ndaj tij nuk është ngritur aktakuzë, plotësohen kushtet për kthim në vendin e punës, duke kërkuar edhe shfuqizimin e vendimit për pezullim dhe kompensimin e diferencës së pagës prej 50% nga data 03.07.2023 deri në anulimin e vendimit për pezullim nga marrëdhënia e punës.

Kolegji i Këshillit, lidhur me çështjen e pezullimit të marrëdhënies së punës së nëpunësit civil, ju referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

- **Nenit 68 paragrafi 1**, “1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil që bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; 1.2. me kërkesë të nëpunëses/it civil”.

- **Nenit 69 paragrafi 1 dhe 2:** “1. Nëpunësja/i civil pezullohet sipas detyrës zyrtare, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 4. të nenit 59 të këtij ligji; 1.2. kur emërohet në një nga funksionet e përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 3 të këtij ligji, për periudhën përkatëse të emërimit; 1.3. transferohet, për nevoja të institucionit, në një organizatë ndërkombëtare apo në një institucion ndërkombëtar, për periudhën përkatëse; 1.4. kur gjykata pezullon nëpunësen/in civil që është person zyrtar nga ushtrimi i detyrës, për kushtet dhe shkaqet të parapara në legjislacionin përkatës në fuqi; **1.5. ndaj nëpunëses/it civil është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të saj/tij;** 1.6. nëpunësja/i civil, mbahet në arrest në pritje të vendimit të formës së prerë; 1.7. deklarohet e/i zhdukur me vendim të formës së prerë të gjykatës, deri në shfaqjen e personit apo deklarimit të vdekjes me vendim të formës së prerë të gjykatës; 1.8. regjistrohet apo zgjidhet, sipas ligjit, si kandidat për zgjedhjet qendrore e lokale, sipas nenit 25 të këtij ligji; 1.9. ndodhet në gjendje konflikti të vazhdueshëm interesi, sipas ligjit të veçantë, deri në transferimin e saj/tij në një pozitë tjetër, në përputhje me nenin 64 të këtij ligji; 1.10. gjatë ndjekjes së ndonjë programi arsimimi apo trajnimit më të gjatë se tridhjetë (30) ditë, për nevojat e institucionit, për periudhën që ndjek këtë program me shkëputje nga puna; 1.11. në raste të tjera, të parashikuara shprehimisht me ligj. **2. Përveç kur përcaktohet ndryshe me këtë ligj, konstatimi i shkakut të pezullimit bëhet nga: 2.1. NjMBNj e institucionit, ku nëpunësja/i ushtron detyrën”.**

- **Neni 71 paragrafi 8 dhe 9:** “8. Nëpunësja/i civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1., nën-paragrafët 1.4., 1.5., 1.6. dhe 1.7. të nenit 69 të këtij ligji, nëpunësja/i civile përfiton pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtesë në pagë, deri në fund të periudhës së pezullimit. 9. Në rast se procedura disiplinore apo procedura penale përfundon pa një masë disiplinore, gjegjësisht dënim penal, nëpunëses/it civil që ka qenë e pezulluar me pesëdhjetë për qind (50%) të pagës së saj/tij, i kompensohet pjesa e ndaluar e pagës bazë”.

Andaj, referuar kuadri ligjor si më lartë si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, pezullimi i marrëdhënies së punës së ankuesit përmes Vendimit Nr. 2109/2023 të datës 20.12.2023, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është bërë mbi bazën e dispozitave të aplikueshme në atë kohë, sepse, ndaj ankuesit ishte filluar procedurë penale mbi dyshimin për veprë penale gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dhe rrjedhimisht, njësia përgjegjëse kishte vepruar drejtë dhe në respektim të plotë së drejtës materiale objektive. Ndërsa, bazuar në njoftimin e datës 01.09.2025, Njesisë së Personelit të MPB-së rrjedhë së Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzë ndaj ankuesit dhe se e njëjta më datë 29.08.2025 është përcjell në gjykatën kompetente..

Përkritazi të me pretendimin e ankuesit për aplikim të nenit 13 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë në fuqi nga data 17.06.2025, Kolegji ju referua dispozitave të nenit 13 të këtij ligji më të cilat është ndryshuar neni 69, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. të ligjit bazik, në atë mënyrë që: 1.5. ndaj nëpunësit civil është ngritur aktakuzë për procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij. Andaj, nisur nga parimi se veprimi retroaktiv i ligjit apo një norme të re ligjore vlen vetëm nëse ligji i ri parashikon këtë veprim prapaveprues dhe se ky veprim prapaveprues është në funksion të parimit të sigurisë juridike pasi që ndjek një qëllim të ligjshëm, Kolegji konstaton se Ligji Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë nuk përmban dispozitë të veçantë lidhur me aplikimin retroaktiv

të nenit 13, kështu që, në mungesë të kësaj dispozite, nuk mund të aplikohet neni 13 në raport me rastet e zyrtarëve që tashme janë pezulluar sipas nenit 1.5 të paragrafit 1 të nenit 69 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë

Deri të një konstatimin i tillë Kolegji mori parasysh praktiken vendimmarrëse të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO46/23, ku në pikën 246 ka përcaktuar: " Bazuar në parimet e shtjelluara si më sipër, rezulton që përderisa parimi i ndalimit të aplikimit retroaktiv të ligjit është rregull shumë i rëndësishëm i parimit të sigurisë juridike dhe sundimit të ligjit, në fushën civile dhe/ose administrative mund të ketë përjashtime nga ky parim, me kushtin që një përjashtim i tillë, të jetë në interesin publik. Për më tepër, në rrethana të tilla, një përjashtim i tillë, duhet të jetë (i) i "përcaktuar me ligj"; (ii) të ndjekë një "qëllim legjitim", dhe në rrethana të ligjeve që përcaktojnë procedura që ndërlidhen me verifikimin e pasurisë së pajustificueshme, si mekanizëm për luftimin e korrupsionin, një përjashtim i tillë, në parim, është vlerësuar që ndjek qëllimin legjitim të interesit publik; dhe (iii) duhet të jetë "proporcional", përkatësisht të balancojë interesin publik dhe ndërhyrjen në të drejta dhe liri themelore, përfshirë në kontekst të parimeve që ndërlidhen me "parashikueshmërinë" dhe "qartësinë" e ligjit...".

Andaj, bazuar si më sipër, Kolegji erdhi në përfundimin se pa përjashtuar konstatimet si në arsyetimin e këtij vendimi, zbatimi i nenit 13 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L197 për Zyrtarët Publikë lidhur me ankuesin është i pamundur, sepse, tashme ndaj ankuesit është ngrit aktakuzë mbi dyshimin për vepër penale gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, fakt ky që përben shkak ligjor për vazhdim të pezullimit të marrëdhënies se punës se ankuesit sipas nenit 13 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik

Thënë si më lartë, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi, 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi..

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRTËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1442/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit A.S;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.